



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI  
KRYETARI**

Nr. 3973 Prot.

Tiranë më 08 .11.2019

**Lënda:** Kërkohet informacion mbi ecurinë e procesit të emërimit/zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

**Drejtuar:** **Z. ARDIAN DVORANI**  
**KRYETAR I KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

I nderuar zoti Dvorani,

Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në datën 11.11.2019, ora 10:00, ka caktuar seancën plenare për miratimin e projektvendimeve për zgjedhjen e dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vakancë e plotë e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 12.2.2018 dhe më datë 4.3.2019.

Komisioni “Për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut” ka përfunduar procedurën dhe ka miratuar raportet për seancën plenare për kandidatët, në bazë të listave të dërguara Kuvendit të Shqipërisë me vendimet nr. 130, datë 21.09.2019 dhe nr. 131, datë 21.09.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në listat e dërguara Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se ka kandidatë që ndodhen të listuar dhe të renditur edhe në listat që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka dërguar Presidentit të Republikës për vakancat e shpallura prej tij.

Në këto kushte, për të garantuar të drejtën e çdo kandidati në votim, Kuvendi i Shqipërisë, brenda ditës së sotme, kërkon të informohet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mbi ecurinë e deritanishme të procesit të emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga Presidenti i Republikës, sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**

**GRAMOZ RUÇI**

